



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS – VLADA KOSOVA – GOVERNMENT OF KOSOVO  
MINISTRIA E FINANCIVE – MINISTARSTVO FINANSIJE – MINISTRY OF FINANCE



# NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE

## RAPORTI VJETOR 2013



**NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE  
FINANSIJSKA OBAVEŠTAJNA JEDINICA  
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT**

## **RAPORTI VJETOR 2013**

# PËRMBAJTJA

<b>1. MESAZHI I DREJTORIT .....</b>	<b>6</b>
<b>2. HYRJA .....</b>	<b>7</b>
<b>3. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA .....</b>	<b>8</b>
<b>3.1. Detyrat.....</b>	<b>8</b>
<b>3.2. Misioni.....</b>	<b>8</b>
<b>3.3. Vizioni .....</b>	<b>8</b>
<b>3.4. Buxheti dhe burimet njerëzore .....</b>	<b>9</b>
3.4.1. Buxheti .....	9
3.4.2. Aktivitetet e Prokurimit.....	10
3.4.3. Burimet njerëzore .....	10
<b>3.5. Teknologjia Informative .....</b>	<b>11</b>
3.5.1. Softuerët.....	11
3.5.2. Harduere .....	11
<b>3.6. Organizimi i NJIF-K .....</b>	<b>11</b>
3.6.1. Mbikëqyrja e NJIF-K .....	11
3.6.2. Struktura organizative.....	11
<b>4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË .....</b>	<b>12</b>
<b>4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare.....</b>	<b>12</b>
4.1.1. Transaksionet e dyshimta.....	12
4.1.2. Raportet e transaksioneve të dyshimta për Financim të Terrorizmit.....	13
4.1.3. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG) .....	14
4.1.4. Analizimi dhe Shpërndarja e raporteve të inteligjencës tek homologët kombëtar dhe ndërkombëtar .....	14
4.1.5. Kërkesat për informata nga homologët kombëtar dhe ndërkombëtar.....	15
<b>4.2. Informatat kthyese .....</b>	<b>17</b>
<b>4.3. Inspektimi i pajtueshmërisë.....</b>	<b>17</b>
<b>4.4. Aktivitetet e trajnimeve .....</b>	<b>18</b>
<b>4.5. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes .....</b>	<b>19</b>
<b>4.6. Publikimi i Tipologjive.....</b>	<b>20</b>
<b>4.7. Zhvillimi i kornizës ligjore.....</b>	<b>20</b>
<b>4.8. Rritja e kapacitetit dhe bashkëpunimit të NJIF.....</b>	<b>21</b>
4.8.1. Teknologjia Informative.....	21
4.8.2. Procedurat Standarde të Veprimit.....	23
4.8.3. Trajnimi i personelit .....	24
4.8.4. Bashkëpunimi me partnerët kombëtar .....	25
4.8.4.1. Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale.....	26
4.8.4.2. Memorandumet e Mirëkuptimit.....	26
4.8.4.3. ILECUs .....	28
4.8.5. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont .....	28
4.8.5.1. Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve.....	28
4.8.5.2. Bashkëpunimi regjional.....	29
4.8.5.3. Memorandumet e Mirëkuptimit.....	29
4.8.5.4. Prosesi i Anëtarësimit në Grupin Egmont.....	30
<b>5. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT</b>	<b>31</b>
<b>5.1. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut 2013 .....</b>	<b>31</b>
<b>5.2. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018.....</b>	<b>32</b>

5.3. Mekanizmi kombëtar i menaxhimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.....	33
6. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE .....	35
6.1. Bashkëpunimi me EULEX-in.....	35
6.2. Projektet e financuar nga BE-ja.....	35
6.3. Projekti i BE&KE “kundër Krimit Ekonomik në Kosovë PECK” .....	36
6.4. Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara.....	37
7. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF KOSOVË 2014-2016 .....	38

## LISTA E SHKURTESAVE

NJIF	Njësia për Inteligjencë Financiare
OJQ	Organizatrat Joqeveritare
PPP	Parandalimi i Pastrimit të Parave
PFT	Parandalimi i Financimit të Terrorizmit
AIF	Raporti i informacioneve shtesë
AKI	Agjensioni Kosovar për Inteligjencë
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AKK	Agjencia kundër Korrupsionit
BE	Bashkimi Europian
BQK	Banka Qëndrore e Republikës së Kosovës
DK	Dogana e Kosovës
EGMONT	Rrjeti i Njësive të Inteligjencës Financiare në Botë
EULEX	Misioni i Bashkimit Europian për sundimin e ligjit në Kosovë
FATF	Task Forca e Veprimit Financiar
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
goAML	Sistemi elektronik i menaxhimit të të dhënave
ILECU	Njësia për bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit
JVI	Instituti i Bashkuar i Vjenës
KE	Këshilli i Europës
MF	Ministria e Financave
MONEYVAL	Komiteti i Ekspertëve për Vlerësimin e Luftës Kundër Pastrimit të Parave
PEP	Personat e Ekspozuar Politikisht.
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
QIF	Qendra e Inteligjencës Financiare
RTD	Raporti i Transaksionit të Dyshimtë
RTG	Raporti i transaksionit në të gatshëm (kesh)
TI	Teknologjia Informativë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
UNODC	United Nations Office on Drugs and Crime

## 1. MESAZHI I DREJTORIT

Legjislacioni dhe puna efektive në kuadër të sistemit kundër Shpërlarjes së Parasë dhe Financimit të Terrorizmit është vendimtare për Republikën e Kosovës të mbështes stabilitetin dhe integritetin e sistemit të tij financiar.

Është viti i tretë që Njësia për Inteligjencë Financiare ka ngritur gjithnjë bashkëpunimin me institucionet e zbatimit të ligjit si dhe sektorin privat për të parandaluar dhe luftuar shpërlarjen e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste.

NJIF-K pranon raporte të transaksioneve të dyshimta dhe të parase se gatshme, por cilesia e këtyre raporteve nuk ishte ruajtur dhe përmirësuar pa një bashkëpunim me subjektet raportuese dhe institucionet e zbatimit të ligjit. Numri i raporteve të transaksioneve të dyshimta edhe pse ka një rënie krahasuar me vitin paraprak (174 – 202), krahasuar me vitin e themelimit të këtij institucioni në vitin 2011 (135 RTD) kemi një ngritje të qëndrueshme të shtimit të aktivitetit dhe raportimit. Në bazë të këtyre shifrave NJIF vlerëson rritjen e nivelit të ndërjegjesimit nga subjektet raportuese dhe mirepret bashkëpunim të vazhdueshëm me këto subjekte.

Dëshiroj të shfrytezoj këtë mundësi për të perseritur se është obligim ligjor në Kosovë për çdo person, pa u kufizuar në zyrtar apo jo zyrtar të paraqes informata lidhur me ndonjë transaksion të dyshimtë kur ai/ajo e di ose dyshon se ndonje prone ose pasuri e ka origjinën nga të ardhurat e rrjedhura nga krimi ose përdoret për aktivitet të financimit të terrorizmit.

Gjatë viteve të fundit, NJIF-K ka bërë përpjekje të rëndësishme për të përmirësuar pozitën e saj institucionale, kapacitetet e saj për të zgjeruar bashkëpunimin me autoritetet e tjera vendore dhe ndërkombëtare dhe për të përmirësuar cilësinë e analizës.

Ngrtja e kapaciteteve operacionale, shkathtësive analitike, mbetet ndër synimet e mëdha të zhvillimit të NJIF-K në harmoni me metodologjitë e avancuara të analizimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, kapaciteteve në fushën e teknologjisë informative me qëllim të arritjes së një kualiteti sa më të lartë të të dhënave të ndjeshme financiare të cilat pranohen nga subjektet raportuese të NJIF-K dhe analizimit sa më të saktë të tyre, e gjithë kjo me qëllim të sigurimit të promovimit të pajtueshmërisë me Ligjin në fuqi mbi Parandalimin e Shpërlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

  
**Dardan NUHIU**  
\_\_\_\_\_  
**Drejtor, Njësia për Inteligjencë Financiare**

## 2. HYRJA


Luftimi efektiv i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit mbetet njëra ndër sfidat e vendit tonë drejt rrugëtimit në integrimet evropiane. Vendi ynë është përpjekur dhe është në përpjekje të fuqizimit të mekanizmave ligjor e institucional për luftë sa më efektive të shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Përpjekjet e NJIF-K për adresimin e ndryshimeve ligjore me qëllim të përafrimit me rekomandimet dhe direktivat ndërkombëtare rezultuan me miratimin e ndryshimeve ligjore të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në Shkurt të vitit 2013.

Legjislacioni sekondar, rritja e vetëdijes dhe bashkëpunimi në lidhje me fenomenin e shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit mbetet një nga sfidat dhe komponentët e angazhimeve në vazhdim të NJIF-K. Në funksion të zbatimit të mandatit të saj ligjor, Njësia për Inteligjencë Financiare ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në drejtim të hetimeve të mëtutjeshme përmes përcjelljes së informacioneve tek autoritetet tjera të zbatimit të ligjit në lidhje me raportet e transaksioneve të dyshimta apo analizave shtesë dhe formave tjera të bashkëpunimit për dyshimet e mundshme për përfshirje në shpëlarje të parave, financim të terrorizmit apo ndonjë veprë tjetër të ndërlidhur penale kundër ekonomisë.

Një Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i kërkuar edhe me rekomandimin e parë të FATF, është përfunduar me sukses në Dhjetor të vitit të kaluar, duke nxjerrë edhe dokumente tjera të rëndësishme për trajtimin e masave të vlerësimit si dhe matrica e analizës dhe vlerësimit për rreziqet individuale. Njëherit ky dokument ka shërbyer si bazë për nxjerrjen e objektivave dhe aktiviteteve të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 dhe Planit të Veprimit. Kjo do të sigurojë menaxhim të qëndrueshëm të rreziqeve. Arritja e këtyrë qëllimeve kërkon që shkalla e ekonomisë joformale duhet të reduktohet dhe vlera e konfiskimit e të ardhurave nga krimi duhet të rritet.

Me qëllim të rritjes së rezultateve në parandalimin dhe luftimin sa më efektiv të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, NJIF-K ka ndërmarrë hapa të mëtutjeshëm për përmirësimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Gjithashtu një ngritje gjithnjë e më e theksuar e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave me agjencitë homologe ndërkombëtare si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojave më të mira në këtë fushë është synim i vazhdueshëm nga ana e NJIF-K.

Raporti i Progresit i Komisionit Europian për vitin 2013 thekson që Kosova ka vazhduar me përmirësimin e legjislacionit të saj në fushën e PPP/PFT dhe ligji i rishikuar zgjeron dhe forcon mandatin e Njesisë. Megjithëse mbetet sfida e institucioneve të zbatimit të ligjit dhe atyre gjyqësore në ngritjen dhe përmirësimin e njohurive të tyre për të qenë në gjendje të trajtimit dhe ndërlidhjes së veprave penale të pastrimit të parave dhe veprave tjera të ndërlidhura.



### **3. ORGANIZIMI I NJIF KOSOVA**

#### **3.1. Detyrat**

NJIF-K është themeluar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizimit (Ligji KPP/LFT)<sup>1</sup>. Është institucion qëndror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave. NJIF-K është përgjegjëse për kërkimin, pranimin, analizimin dhe shpërndarjen e informatave tek autoritetet kompetente që kanë mandat hetimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Mandati dhe kompetencat e NJIF-K si dhe obligimet e Subjekteve Raportuese dhe përgjegjësitë e tyre janë të definuara në Ligjin KPP/LFT.

Kompetencat dhe funksionet e NJIF-K janë siç vijon:

1. Pranoj, ruaj dhe analizoj raportet e aktiviteteve të dyshimta (RAD), raporteve të transaksioneve të parave të gatshme (RTPG) dhe informatat nga burimet tjera të lidhura me dyshim të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
2. Shpërndaj informatat që kanë të bëjnë me dyshimet mbi pastrimin e parave apo financimin e terrorizmit tek organet kompetente hetuese;
3. Mbikëqyr dhe inspekton subjektet raportuese për të siguruar pajtueshmëri me obligimet e raportimeve dhe mbajtjen e shënimeve;
4. Shkëmben informata dhe bashkëpunim me NJIF-at në juridiksionet tjera dhe me organet tjera hetuese dhe rregullative;
5. Trajnon subjektet raportuese dhe personelin hetues dhe rregullativ; dhe
6. Rekomandon për masat legjislative dhe politike që duhet të ndërmerren për të përmirësuar masat kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

#### **3.2. Misioni**


Misioni i NJIF-K bazuar në mandatin ligjor është të udhëheq përpjekjet e Qeverisë për të përmirësuar parandalimin dhe luftimin kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar. Funksionimi i duhur i sistemit në përgjithësi, përmes bashkëpunimit të ngushtë institucional dhe aktiviteteve të Njesisë së Inteligjencës Financiare është objektiva kryesore e NJIF-K.

#### **3.3. Vizioni**

Vizioni i NJIF-K është që në të ardhmen e afërt, të konsiderohet si një nga Njësitë e Inteligjencës Financiare më të avancuara në regjion në terme të aspekteve legjislative dhe organizative si dhe të arrij anëtarësimin në organizatat Evropiane dhe Ndërkombëtare në këtë fushë.

---

<sup>1</sup> Ligji Nr. 03/L-196 dhe Ligji Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 2010 dhe 2013.





### 3.4. Buxheti dhe burimet njerëzore

#### 3.4.1. Buxheti

NJIF-K e ka të përcaktuar buxhetin e saj vjetor. Drejtori i NJIF-K definon nevojat buxhetore dhe dorëzon propozimin në Bord që përcakton buxhetin e njësisë. Ky propozim është i bazuar në plane për dy periudha kohore: një (1) vit dhe tri (3) vite. Ai përmban burimet njerëzore, nevojat e TI dhe operacionale. Ambienti dhe nevojat operacionale të NJIF-K janë analizuar dhe marrur në konsideratë gjatë planifikimit buxhetor. Buxheti final përcaktohet në baza vjetore nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Drejtori, së bashku me Udhëheqësit e Departamenteve, dhe personelin e buxhetit dhe financave formulojnë propozimin për buxhetin e NJIF-K. Pasqyra e pranimeve (alokimeve) dhe pagesave të parave të gatshme për NJIF-K nga fondi i BKK sipas kategorive ekonomike për vitin 2013 është paraqitur në tabelen si ne vijim:

Buxheti dhe burimet njerëzore të NJIF-K 2013-2016	
	2013
Buxheti vjetor	334,250
Pagat dhe mëditjet	127,161
Mallrat dhe shërbimet	123,589
Shpenzimet komunale	13,500
Shpenzimet kapitale	70,000
Numri i të punësuarve të NJIF-K	18
Eulex	4

Tabela nr.1

Në tabelën e lartë cekur është paraqitur buxheti fillestar i NJIF-K në vlerë prej 334,250 €, ndërsa buxheti final ka qenë 351,050€, duke pasur parasysh se në kategorinë e pagave dhe mëditjeve pas rishikimit të buxhetit, NJIF-K ka pasur rritje të buxhetit në shumë prej 16,800 €.

NJIF-K për periudhën Janar - Dhjetor 2013, ka realizuar buxhetin në vlerë prej 334,360 € ose e shprehur në përqindje 95.25 %.

Në vazhdim janë paraqitur shpenzimet për secilën kategori ekonomike:

- Buxheti për paga dhe mëditjeve për vitin 2013 nga BKK-ja, sipas ndarjes fillestare ka qenë 127,161 €, kurse me rishikim të buxhetit është ngritur për 16,800 € ashtu që buxheti final për këtë kategori për vitin 2013 ka qenë 143,961€, ndërsa për këtë periudhë është shpenzuar në vlerë prej 141,965 € ose e shprehur në përqindje 98.61 % si në tabelën më lartë.
- Buxheti i shpenzuar për vitin fiskal 2013 për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve është 113,271 € ose i shprehur në përqindje 91.65 %.
- Në kategorinë e shërbimeve komunale vlera e shpenzuar për këtë kategori ekonomike është 10,291 € ose e shprehur në përqindje 76.23 %.
- Në kategorinë e Investimeve Kapitale vlera e shpenzuar për këtë kategori ekonomike është 68,842 € ose e shprehur në përqindje 98.35 %.

### 3.4.2. Aktivitetet e Prokurimit

Gjatë vitit 2013 sipas Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042 janë zhvilluar gjithsej njëmbëdhjetë (11) aktivitete të prokurimi.

Sipas procedurës aktivitete të prokurimit janë të ndara në :

- Dy (2) aktivitete të prokurimit kanë qenë me procedurë të hapur,
- Dy (2) aktivitete kanë qenë me procedurën e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë,
- Tre (3) aktivitete kanë qenë me procedurën e kuotimit të çmimeve dhe
- Katër (4) aktivitete kanë qenë me procedurën e vlerës minimale.

Ndërsa sipas vlerës së planifikuar të prokurimit

- Tre (3) janë me vlerë të mesme,
- Katër (4) janë me vlerë të vogël dhe
- Katër (4) janë me vlerë minimale.

### 3.4.3. Burimet njerëzore

Në vitin 2013 NJIF-K ka pasur të punësuar gjithsej 18 zyrtar lokal. Personeli përfshin menaxhimin e institucionit, administratën, personelin e TI dhe operacional. NJIF-K ka një (1) zyrtar sekondar nga Dogana e Kosovës për të përmirësuar shkëmbimin e informatave dhe bashkëpunimin operacional. NJIF-K është pajtuar gjithashtu edhe me Administratën Tatimore dhe Policinë e Kosovës për ndërlidhjen e zyrtarëve sekondar në njësi.

Përveç personelit lokal, janë gjithsej edhe tre (4) përfaqësues të EULEX-it që punojnë në NJIF-K. Njëri nga ekspertët ndërkombëtar është këshilltar i Drejtorit të njësisë dhe dy të tjerët janë analista të inteligjencës dhe një Asistent Administrativ.

Kontrollet e brendshme janë bazuar në menaxhimin ditor dhe mbikëqyrjen e Planit të Performancës dhe Burimeve. Udhëheqësit e Departamenteve menaxhojnë funksionet e tyre dhe raportojnë tek Drejtori. Raportet Mujore të Performancës janë hartuar për të siguruar transparencën, efikasitetin dhe burimet e duhura. Implementimi i objektivave është i përcjellë dhe masat ndërmerren në mënyrë të duhur.

Funksioni i kontrollit të brendshëm ndihmon organizatën dhe Drejtorin të përmbushin objektivat e tyre duke ofruar qasje sistematike e disiplinore për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e proceseve operacionale, menaxhimin e rrezikut, kontrollin dhe procedurat qeverisëse.

Njësia për Inteligjencë Financiare	Nr i punëtorëve në Ligjin e buxhetit (pozitat e aporovuara)	Nr i punëtorëve në fillim të 2013	Nr i punëtorëve në fund të 2013
Stafi lokal	20	18	17
Stafi ndërkombëtar EULEX-it	//	4	4
Staf i huazuar nga Dogana e Kosovës dhe ATK	//	1	1

Tabela nr.2

### 3.5. Teknologjia Informative

#### 3.5.1. Softuerët

NJIF-K është duke përdorur sistemin e raportimit dhe databazë të menaxhimit të rasteve goAML të krijuar nga UNODC. Sistemi gjithashtu përdoret si program i sigurtë i shkëmbimit të informatave me disa nga FIU homologe të huaja. Ai ofron mjete shtesë të analizës për analiza financiare. UNODC është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të goAML.

#### 3.5.2. Harduere

NJIF-K ka një plan tre vjeçar për investime në TI. Kjo njëherit merr edhe pjesën më të madhe të investimeve kapitale nga buxheti vjetor i njësisë.

### 3.6. Organizimi i NJIF-K


#### 3.6.1. Mbikëqyrja e NJIF-K

NJIF-K ka Bordin që mbikëqyr dhe siguron pavarësinë e njësisë. Ai përbëhet nga Ministri i Financave që shërben si Kryetar i Bordit. Anëtarët tjerë përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Kryeprokurorin e Kosovës, Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Drejtorin e Administratës Tatimore, Drejtorin e Përgjithshëm të Doganës së Kosovës dhe Drejtorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Bordi nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në asnjë mënyrë në çështjet në proces të NJIF-K-së.

#### 3.6.2. Struktura organizative

NJIF-K udhëhiqet nga Drejtori i cili është përgjegjës për drejtimin dhe menaxhimin e njësisë. Në kuadër të punëve operacionale në NJIF-K ekzistojnë tri departamente kryesore: Departamenti Operacional dhe i Analizave, Departamenti i Pajtushmërisë dhe Inspektimit dhe Departamenti i TI. NJIF ka gjithashtu zyrën ligjore që merret me çështjet ligjore dhe ndërkombëtare.

Struktura Organizative e Njësisë së Inteligjencës Financiare është siç vijon:




## 4. PERFORMANCA E NJIF KOSOVË

### 4.1. Pranimi, analizimi dhe shpërndarja e inteligjencës financiare

#### 4.1.1. Transaksionet e dyshimta

Sikurse në dy vitet e mëparshme, trendi i raportimit të transaksioneve të dyshimta (RTD) ka vazhduar thujtë në numra të përafërt, të cilat raporte në vitin 2013 kanë rezultuar me një total prej 174 RTD. Numri i transaksioneve të përfshira në ato raporte të transaksioneve të dyshimta ishte 564 transaksione të dyshimta, shprehur në vlerë monetare në shumë prej afër 35 milion euro. Krahasuar me vitin 2012 (202 RTD të raportuara) ka një rënie prej 28 raporte të transaksioneve të dyshimta apo rreth 16 %. Edhe pse ka një rënie të RTD-ve me vitin e kaluar, krahasuar me vitin 2011 ka rezultuar që këto raporte të kenë një rritje në total prej 39 RTD.

Grafikoni Nr.1



Rezultatet e NJIF-K	2011	2012	2013
RTD-të e pranuar	135	202	174

Tabela nr.3

Ashtu si në vitet e kaluara, pjesa më e madhe e RTD-ve të pranuar nga NJIF-K ishte paraqitur nga Bankat dhe institucionet financiare. Përveq kësaj nga ky vit vërehet një gadishmëri e disa prej subjekteve tjera raportuese për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore në lidhje me detyrimet e tyre për raportim.

Përderisa, disa nga subjektet tjera raportuese vazhdojnë të jenë të përfaqësuara në numër jashtëzakonisht të vogël në dërgimin e raporteve, sidomos ato subjekte që kërkohen për të raportuar në pajtim me nenin 24-28 të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë këtu: avokatët, kontabilistët dhe auditorët, kazinot dhe lojrat e fatit, partitë politike, kompanitë e ndërtimit etj. Kjo tregon që ka një prirje shumë të ulët të përpjekjeve të tyre për të qenë në harmoni me ligjin.



2013		
Informacionet statistikore mbi raportet e dyshimta të pranura nga NJIF		
Subjekti raportues	Raporet në lidhje me transaksionet e dyshimta	
	PP	FT
<b>Bankat dhe Institucionet Financiare</b>		
Bankat	159	6
Kompanitë e Sigurimeve	0	0
Këmbimoret (Shkëmbimi i valutave)	0	0
Agjensionet për Transfer Parash	6	0
<b>BPPJF-të</b>		
Kazinot	0	0
Agjentët e patundshmërive	0	0
Tregtarët me metale/gurë të çmuar	0	0
Avokatët	0	0
Noterët	1	0
Kontabilistët e çertifikuar dhe këshilltarët tatimor	0	0
Auditorët e licencuar	0	0
Ofruesit e shërbimeve të trustit dhe kompanive	0	0
Profesionistët e tjerë	0	0
<b>ENTITETET TJERA RAPORTUESE</b>		
Dogana e Kosoves	0	1
Tjera	1	0
<b>Totali</b>	<b>167</b>	<b>7</b>
<i>Tabela nr.4</i>	174	

#### 4.1.2. Raportet e transaksioneve të dyshimta për Financim të Terrorizmit

Nga sa u tha më lartë për numrin e raporteve të dyshimta të pranura nga NJIF-K për vitin 2013, nga 174 raporte në total të pranura, shtatë (7) prej tyre ishin raportuar për financim të terrorizmit. Shumica e këtyre raporteve të pranura nga ana e NJIF-K, pas analizimit, përpunimit dhe grumbullimit të informacioneve tjera të inteligjencës, janë shpërndarë tek institucionet tjera kompetente të zbatimit të ligjit për hetime të mëtutjeshme.

Në fund të vitit raportues janë bërë përpjekjet për ndarjen e Raportit të financimit të dyshuar të terrorizmit, i cili është bërë si një Raport i veçantë i Transaksioneve të Dyshimta (RTD). Raportet për financimin e dyshuar të terrorizmit do të jenë prezentë me statistika të ndara nga viti 2014 e tutje.




#### 4.1.3. Raportimi i Transaksioneve në para të gatshme (RTG)

Sipas ligjit në fuqi dhe mandatit të saj operativ, Njësia për Inteligjencë Financiare pranon raportet e transaksioneve në të gatshme (kesh) në vlerë prej dhjetëmijë (10.000) Euro ose më shumë nga subjektet raportuese të cilat janë të obliguara që të raportojnë këto transaksione me ligj.

Numri i raporteve të transaksioneve në para të gatshme është rritur mes viteve 2011 dhe 2013. Në vitin 2013 numri i raporteve të transaksioneve në para të gatshme ka arritur një lartësi mbi 600 000.

Grafikoni Nr.2



Rezultatet e NJIF-K	2011	2012	2013
RTG të pranuar	423 443	480 479	606,778


Tabela nr.5

#### 4.1.4. Analizimi dhe Shpërndaria e raporteve të inteligjencës tek homologët kombëtar dhe ndërkombëtar

Pas mbledhjes dhe analizimit të informatave apo transaksioneve të dyshimta, NJIF-K hap raste sipas dyshimit dhe bën shpërndarjen e rasteve tek institucionet e zbatimit të ligjit. Gjatë vitit 2013 janë hapur gjithsej 312 raste, prej të cilave 118 kanë rrjedhur nga raportet e aktiviteteve të dyshimta të pranuar në NJIF-K dhe të raportuara kryesisht nga subjektet e obliguara të raportojnë, por një pjesë e tyre janë hapur edhe nga informacioni i pranuar në NjIF, përderisa 190 raste janë hapur bazuar në kërkesat për informata dhe bashkëpunimit ndër-agjensi. Gjithashtu NJIF-K në bashkëpunim me agjensione tjera të zbatimit të ligjit është duke punuar në 4 raste për analizim dhe hetim të përbashkët.

Numri i raporteve të inteligjencës të shpërndara është rritur dukshëm krahasuar me vitin paraprak 2012.

Grafikoni Nr.3



Rezultatet e NJIF-K	2011	2012	2013
Raportet e shpërndara të inteligjencës	40	45	74


Tabela nr.6

Duhet cekur se shumica e raporteve janë shpërndarë për hetime të mëtutjeshme tek Policia e Kosovës. Edhe pse numri i raporteve të shpërndara është rritur, NJIF-K është fokusuar në rritjen e të dyjave kualitetit dhe kuantitetit të shpërndarjes së raporteve në mënyrë që të rritet numri i hetimeve dhe ndjekjeve që zhvillohen në bazë të punës së NJIF-K.

Dërguar tek	Viti 2013	%
Policia e Kosovës	44	59.46%
Administrata Tatimore e Kosovës	21	28.38%
Dogana e Kosovës	4	5.41%
EULEX	2	2.70%
Fiu ndërkombëtare	3	4.05%
<b>Gjithsej Rastet e Shpërndara</b>	<b>74</b>	<b>100%</b>

Tabela nr.7

Grafikoni Nr.4



#### 4.1.5. Kërkesat për informata nga homologët kombëtar dhe ndërkombëtar

Numri total i kërkesave që NJIF-K ka pranuar nga autoritetet kombëtare në 2013 tregojnë një rritje të qëndrueshme të bashkëpunimit mes NJIF-K dhe partnerëve kombëtar. Kjo tregon që puna e NJIF-K tani është zgjeruar edhe më tepër dhe se funksionet dhe roli i NJIF-K është bërë i njohur në vend. Kërkesat nga NJIF-at e huaj kanë mbetur në numër të qëndrueshëm.




<b>Rezultatet e NJIF-K</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga autoritetet vendore	64	103	183
Numri i kërkesave për informata të pranuar nga FIU homologe të huaja	10	10	7
<b>Total kërkesat për informata të pranuar në NJIF-K</b>	<b>74</b>	<b>113</b>	<b>190</b>

*Tabela nr.8*

Në kuadër të kërkesave për informata, Njësia për Inteligjencë Financiare gjatë vitit 2013 ka pranuar gjithsej 190 kërkesa për informata nga institucionet e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare të zbatimit të ligjit dhe të njëjtave u është kthyer përgjigje pasi që informata apo të dhënat janë kompletuar apo analizuar nga ana e NJIF-K. Nëse këto të dhëna i krahasojmë me kërkesat e një viti më parë, shihet se në vitin 2013 kemi gjithnjë e në rritje numrin e kërkesave të tilla, ku vetëm në vitin 2011 dhe 2012 kemi pasur 74 gjegjësisht 113 kërkesa për informata, përdërisa ky numer në vitin 2013 ka arritur në 190 raste. Kjo përveç tjerash tregon edhe ngritje të bashkëpunimit mes institucioneve të zbatimit të ligjit, si dhe rritjes gjithnjë e më tepër të profesionalizmit të këtij institucioni.

*Grafikoni Nr.5 Kërkesat për Informata të pranuar dhe shpërndara*



Përveç pranimit dhe analizimit të atyre informatave të pranuar, NJIF-K ka bërë edhe shpërndarjen e raporteve të inteligjences bazuar në pranimin e kërkesave për informata.

<b>Rezultatet e NJIF-K</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek autoritetet vendore	71	104	174
Numri i kërkesave për informata të shpërndara tek FIU homologe të huaja	11	13	5
<b>Total kërkesat për informata të shpërndara nga NJIF-K</b>	<b>82</b>	<b>117</b>	<b>179</b>

*Tabela nr.9*





## 4.2. Informatat kthyese

Gjatë vitit 2013, janë pranuar gjithsej 96 informata kthyese për 103 raste që NJIF-K ka shpërndarë informacion të dyshimtë tek institucionet e ndjekjes penale, kryesisht në vitet 2010 - 2013. Rreth 95 % e këtyre informatave kthyese kanë ardhur nga Policia e Kosovës (Departamenti për Hetimin e Krmieve Ekonomike dhe Korrupsion), përderisa rreth 3% përkatësisht 1 % janë dërguar raporte nga ATK-ja dhe Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

Rezultatet e rasteve të iniciuara nga NJIF-K dhe të prezantuara në ato raporte të informatave kthyese kanë treguar që rreth 30 % e rasteve janë nën hetime, 22 % e atyre rasteve janë referuar në Prokurori qoftë Specialen apo Prokuroritë tjera kompetente, rreth 14 % e raporteve janë përcjellur në departamente tjera të Policisë së Kosovës (qoftë në njësi regjionale apo departamente të krimit të organizuar), rreth 8 % e rasteve janë nën trajtim ose është ngritur kallëzimi penal, përderisa të arrestuar janë edhe 7 persona nën dyshimin e përfshirjes së tyre në pastrim të parave. Këto hetime gjithashtu kanë treguar që në dy raste ka pasur shmangie tatimore në vlerë prej rreth 602,651 Euro, mjete këto të kthyera në Buxhetin e Kosovës. Njëherit duhet cekur se nga gjithsejt këto informata kthyese, rreth 20% e tyre janë Hedhur poshtë kallëzimet penale, janë Pushimuar Hetimet ose mbyllur rastet

Gjatë hetimeve ka rezultuar që dyshimet kryesore për veprat e ndërlidhura penale të rezultojnë me:

Veprat e Ndërlidhura penale me PP	Numri I Rasteve
Aktivitete te dyshimta financiare	24
Shmangie nga Tatimi	39
Trafikim me qenje njerëzore	2
Shpërlarje e parave	24
Keqpërdorim te kartelave bankare, mashtrim dhe fallsifikim	3
Shpërlarje te parasë dhe krim të organizuar	1
Kontrabandë	1
Shpërlarje të parasë dhe organizim te skemave piramidale	2

Tabela nr.10

## 4.3. Inspektimi i pajtueshmërisë

Me plotësim ndryshimin e ligjit për PPP/PFT, NJIF-K i është dhënë kompetenca më të zgjeruara për inspektimin e pajtueshmërisë së subjekteve raportuese. Me qëllim të përmbushjes së këtij obligimi ligjor, NJIF-K gjatë vitit 2013 ka përgatitur infrastrukturën ligjore me udhëzime administrative të nevojshme për një fillim të mbarë të inspektimeve të pajtueshmërisë. Në tremujorin e fundit të vitit 2013 janë draftuar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) për Mbikëqyrjen e Pajtueshmërisë. Në lidhje me këto procedura është organizuar trajnim për analistët e NJIF-K nga projekti i B&S.



Fillimit të inspektimeve të pajtueshmërisë i ka parapri hartimi dhe hyrja në fuqi e planit vjetor 2014 për inspektimet e pajtueshmërisë në subjektet raportuese. Hartimi i planit vjetor të inspektimit sipas PSO-së është bërë sipas një vlerësimi të përgjithshëm të rrezikut që paraqesin kategoritë e caktuara të subjekteve raportuese në fushën e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.


#### **4.4. Aktivitetet e trajnimeve**

NJIF-K ka mbajtur dhe ka qenë pjesëmarrëse në disa trajnime të ndryshme e po ashtu ka pasur kontakte për këshillim si dhe konsultim lidhur me raportimin e subjekteve duke përfshirë: Përmirësimi i kualitetit të raportimit, Përcjellja e direktivave të NJIF-it, Forma e raportimit për subjektet e regjistruara gjate këtij viti, Ndhma dhe këshillimi sa i përket sistemit të IT-së.

NJIF-K me qëllim të sigurimit dhe promovimit të pajtueshmërisë së subjekteve raportuese me ligjin në fuqi ka miratuar një Urdhresë Administrative Nr. 001/2013 “Trajnimet për Parandalimin dhe Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit” i cili ka hyrë në fuqi me datë 31/10/2013 si dhe planin e trajnimeve për vitin 2014, ku parashihet dhënia e trajnimeve për të gjitha subjektet raportuese.

Sipas kompetencave dhe detyrave të përcaktuara me ligjin për PPP/PFT, në fund të vitit 2013 është përpiluar plani vjetor i trajnimeve dhe punëtorive për subjektet raportuese i cili përveq tjerash përfshin trajnimin e të gjitha subjekteve raportuese dhe një numër të konsiderueshëm të zyrtarëve që pritet të trajnohen në lidhje me obligimet ligjore të raportimit si dhe për parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe veprave tjera të ngjashme.

Modulet e trajnimit do të përqendrohen në obligimet e raportimit me PPP/PFT, menaxhimin e informacioneve, inspektimin e pajtueshmërisë, vetëdijesimin, parandalimin, ndjekjen penale, dhe të dhënat tjera specifike që ndërlidhen me nevojat e subjekteve raportuese.



Përbërja dhe struktura e organizimit të trajnimeve, moduleve dhe materialeve relevante do të dizajnohen në bashkëpunim me mbikëqyrësit sektorial të subjekteve raportuese.

Muaji	Subjekti raportues	Trajnim/Punëtori	Tema	Mbështetësit
Janar	Institucionet Mikrofinanciare	Trajnim	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	/
	Noterët	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit Përpilimi i kontratave	Oda e Noterëve
Shkurt	NGO	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	B&S Project
Mars	Kompanitë e Sigurimeve	Trajnim	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	BQK
	Auditorët dhe Kontabilistët	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	ShKÇAK
Prill	Partitë Politike	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore	KQZ B&S Project
	Kazinotë	Trajnim	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	B&S Project ATK
Maj	Institucionet tjera financiare	Trajnim	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe mënyra e raportimit	BQK B&S Project
	Bankat	Trajnim		BQK B&S Project
Qershor	Agjensionet e Patundshmërive	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore	/
Korrik	Auto-sallonet	Trajnim	PPP/PFT, Obligimet ligjore	/
Gusht	/	/	/	/
Shtator	Avokatët	Punëtori	PPP/PFT, Obligimet ligjore dhe standardet minimale të raportimit	Oda e Avokatëve
Tetor	Kompanitë e ndërtimeve	Punëtori	PPP/PFT	/
Nëntor	Shitësit e metaleve të çmuara	Punëtori	PPP/PFT	/
Dhjetor	Vlerësimi i trajnimeve dhe punëtorive të mbajtura gjatë vitit 2014 Vlerësimi i nevojave për trajnime dhe punëtori për vitin 2015			

Tabela nr.11 Plani Vjetor i Trajnimeve për subjektet raportuese

#### 4.5. Aktivitetet e ngritjes së vetëdijes

Në Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve financiare ishte nxjerrë rekomandim që në Planin e Veprimit të caktohet edhe një nga objektivat kryesore “Ngrijta e



vetëdijes për ndikimet në ekonomië joformale dhe krimeve financiare” i cili objektiv përmban disa nga aktivitetet për ngritjen e vetëdijes.

Njësia e Inteligjencës Financiare është përqendruar në trajnimin e stafit dhe ngritjen e vetëdijes së shoqërisë, me anë të aktiviteteve informuese dhe formave tjera të përcaktuara me ligj. Poashtu, në vazhden e bashkëpunimit sa më të ngushtë me subjektet raportuese, NJIF ka vazhduar me formën e takimeve individuale me subjektet raportuese, duke u fokusuar në takimet periodike me të gjitha bankat komerciale në vend si dhe në takime të veçanta dhe me shoqatën e noterëve të Kosovës. Këto takime kanë rezultuar mjaft pozitive, ku janë diskutuar dhe shtjelluar format më të mira të raportimit, njëherit NJIF u ka ofruar rekomandime dhe udhëzime për qështje që lidhen përmbushjen e obligimeve ligjore të tyre dhe bashkëpunimin sa më efektiv reciprok.

#### 4.6. Publikimi i Tipologjive

Me qëllim të njoftimit të opinionit lidhur me punën e NJIF-K, është bërë publikimi i një studimi të tipologjive lidhur me veprat penale të Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT), duke pasqyruar rrezikun që paraqitet në raste të ndryshme dhe bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të zbatimit të ligjit në raste konkrete.

Tipologjitë e paraqitura përmes atij raporti, poashtu do të jenë në ndihmë të subjekteve raportuese për të kuptuar natyrën e PP /FT dhe kërcënimeve të tyre, ku në mes tjerash do të jenë në mbështetje të dizajnit të strategjive efektive për të trajtuar këto kërcënime.


Këto tipologji gjithashtu u ndihmojnë edhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit për të hetuar dhe ndjekur personat e përfshirë në PP dhe FT, si dhe hartimin dhe zbatimin e masave efektive parandaluese.

Botimin dhe publikimin e këtyre tipologjive e ka mbështetur dhe financuar Projekti i BE

#### 4.7. Zhvillimi i kornizës ligjore

Me datë 8 mars 2013 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / Nr. 5 / 8 MARS 2013, është publikuar Ligji Nr. 04/L-178 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-196 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimin e Financimit të Terrorizmit i cili është

“mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimin e krimit financiar dhe ekonomik”.



shpallur me dekretin Nr. DL-003-2013, datë 26.02.2013 nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas publikimit.

Hyrja në fuqi e plotësimit ndryshimeve të ligjit ka sjell kompetenca dhe obligime të rëndësishme ligjore për Njësinë për Inteligjencë Financiare dhe për subjektet raportuese të NJIF-K. Këto obligime kanë të bëjnë me vlerësimin e rrezikut kombëtar të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, inspektimet e pajtueshmërisë, sanksionet administrative, financimin e terrorizmit, detyrimet shtesë të kazinove dhe objekteve të licencuara të lojërave të fatit, personat e ekspozuar politikisht etj.

Me qëllim të implementimit të plotësimit ndryshimeve të ligjit, NJIF-K në vitin 2013 ka krijuar një plan të punës që përmbante listën e akteve nënligjore të cilave i është dhënë prioritet i veçantë për tu hartuar, rishikuar apo plotësuar. Objektiva ishte të sigurohet implementim i plotë dhe korrekt i Ligjit për Parandalim të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

NJIF-K në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Projektin e financuar nga BE-ja ka hartuar Udhëzimet Administrative të mëposhtme të cilat janë miratuar në vitin 2013:

1. Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit;
2. Udhëzimi Administrativ për Përpilimin e Statistikave, Raporteve dhe Rekomandimeve për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit;
3. Udhëzimi Administrativ për Trajnimet për Parandalimin dhe Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

NJIF-K në vitin 2013 ka iniciuar edhe hartimin e Udhëzimeve Administrative si në vijim:


1. Udhëzimi Administrativ për Procedura të Shqiptimit të Sanksioneve Administrative ndaj Subjekteve Raportuese që nuk janë në Pajtueshmëri me LPP/PFT
2. Udhëzimi Administrativ për Kompanitë e Ndërtimit;
3. Udhëzimi Administrativ mbi Përjashtimin e Transaksioneve të caktuara nga Raportimi;
4. Kodi i Mirësjelljes së NJIF-K;
5. Udhëzimi Administrativ mbi Standardet Minimale, Procedurat e Shkruara dhe Kontrollat për Parandalimin dhe Zbulimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit nga Profesionistët në fjalë
6. Udhëzimi Administrativ për Parandalim dhe Zbulim e Pastrimit të Parave;
7. Udhëzimi Administrativ për Personat e Ekspozuar Politikisht;
8. Udhëzimi Administrativ për Parandalimin dhe Zbulimin e Financimit të Terrorizmit.

NJIF-K do të finalizoj udhëzimet administrative të identifikuar si legjislacion i nevojshëm sekondar dhe pritet që ti aprovoj në vitin 2014.

#### **4.8. Rritja e kapacitetit dhe bashkëpunimit të NJIF**

##### **4.8.1. Teknologjia Informative**

NJIF-K ka vazhduar progresin në implementimin e sistemit për Analiza, Raportim dhe Shkëmbim të informacioneve përmes sistemit të sigurtë goAML, duke pasur si Objektivë rritjen



e kualitetit të inteligjencës dhe efikasitetin e Analizave. Në këtë progres kontribut të madh ka dhënë edhe Projekti i financuar nga BE-ja.


Ekspertët e NJIF-K së bashku me mbështetjen e Projektit të financuar nga BE-ja hartuan Procedurën Standarde të Veprimit për të standardizuar proceset e punës bazuar në goAML dhe përdorur sa më mirë optionet të cilat i ofron ky sistemi i avancuar.

NJIF-K në vitin 2013 ka iniciuar një proces që rezultoj në shkëmbimin automatik të informatave me Policinë e Kosovës. NJIF-K i asistuar nga Projekti i BE-së për këtë qëllim krijoi një sistem i ri i cili i nxjerr, krahason dhe paraqet vizualisht përmes I2-base të dhënat e marra nga Baza e të dhënave të Policisë së Kosovës dhe sistemit goAML. Ky sistem i ri dukshëm lehtësoj procesin e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Procedura Standarde e Ndërveprimit (NJIF-K dhe Policia e Kosovës) që definojnë bazën ligjore dhe zgjidhjen teknike është hartuar siç duhet.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është kryer upgrade i sistemit goAML në versionin 3.4 dhe ka filluar përgatitja për kalimin në versionin 4.0 i cili ofron mundsi të reja të cilat deri më tani nuk kanë qenë të mundura.



Investimet e kryera në harduer të ri bazuar në planin e investimeve kapitale të TI-së. Ky harduer (Server, Kompjuter, Skaner, Printer, etj) u fut tërësisht në përdorim duke e krijuar një sistem të ri Unsecure duke zëvendësuar komplet sistemin e bazuar në sistemin operativ Linux Ubuntu më sistemin Windows.



Poashtu si pjesë e investimeve kapitale të TI-së është realizuar projekti për ndryshimet në pajisjet me Firewall të gjeneratës më të fundit. Njëherit me sukses u krye vendosja e tyre në rrjetë. Implementimi i pjesës së mbrojtjes së Rrjetës së NJIF-K mundësoj plotësimin e standardeve ndërkombtare të sigurisë së të dhënave.

Ripërtrirja e Sistemit të Kamerave monitoruese të ndërtesës së NJIF-K ishte krye me sukses dhe rritja e kapacitetit të inqizimit dhe ruajtjes së videos. Me implementimin e këtij projekti u plotsuan standardet të cilat lidhen me sigurinë e ndërtesës dhe personelit të NJIF-K.

Investimet kapitale të TI-së në vitin 2013 shpenzuan pjesën më të madhe të buxhetit vjetor të Njesisë.

Gjatë tërë vitit 2013 pandërprerë u punua në integrimin e të gjitha Agjensive dhe subjekteve raportuese të cilat kryejnë komunikime elektronike të përditshme me NJIF-K në sistemin goAML Message Board (Këmbimoret, Mikrofinancat, Policia e Kosovës, ATK, Dogana e Kosovës, etj), dhe kjo mundësoj që komunikimi apo shkëmbimi i informatave me NJIF-K të bëhet mbi 95% në formë elektronike dhe të shpejtë.


#### 4.8.2. Procedurat Standarde të Veprimit

NJIF-K me mbështetjen e projektit të financuar nga BE vlerësoj nevojat për të themeluar apo rishikuar Procedurat Standarde të Veprimit të aplikuara në agjenci. Objektiva e saj ishte të zhvillohen edhe më tutje proceset e punës në NJIF-K dhe mekanizmat e saj të bashkëpunimit me institucionet relevante për të siguruar arritjet e efikasitetit më të lartë të mundshëm dhe efektshmëri në implementim të aktiviteteve të mandatuara të njesisë.

NJIF-K në mbështetje të projektit të financuar nga BE ka përgatit listën e prioritizuar të Procedurave Standarde të Veprimit që duhet të krijohen. Dokumentat e mëposhtme janë hartuar gjatë vitit 2013:

1. Procedura Standarde e Veprimit në Mbikëqyrjen e Pajtushmërisë KPP/LFT;
2. Procedura Standarde e Veprimit për Proceset e Punës Bazuar në goAML të NJIF-K;
3. Procedura Standarde e Veprimit në Kërkesat Automatike të Informatave nga NJIF-K në Policinë e Kosovës;
4. Procedura Standarde e Veprimit në Bashkëpunimin ndërmjet NJIF-K dhe BQK në mbikëqyrjen e pajtushmërisë për PPP/PFT;
5. Plani i Performancës dhe Burimeve 2014-2016 i NJIF-K;
6. Procedura Standarde e Veprimit në Kërkesat Automatike të Informatave mes NJIF-K dhe Administratës Tatimore të Kosovës;
7. Procedura Standarde e Veprimit në Vlerësimin e Rrezikut të Sektorit Specifik në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë;
8. Procedura Standarde e Veprimit në manualin e Përdorimit të Ueb goAML për Subjektet Raportuese; dhe
9. Procedura Standarde e Veprimit në Manualin për Modelet e goAML.

NJIF-K do të finalizoj themelimin e Procedurave të identifikuar Standarde të Veprimit në 2014 dhe do i përcjell ato për përdorim operacional së bashku me partnerët relevant.



#### 4.8.3. Trajnimi i personelit


Rëndësi të veçantë i është kushtuar aspektit të ngritjes profesionale të personelit që merret me analiza dhe inspektime në lidhje me dyshimet potenciale të shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit. Ngritja profesionale është bërë kryesisht përmes pjesëmarrjes së stafit të NJIF-it në trajnime dhe seminare të ndryshme, të organizuara nga partnerët tonë lokal dhe organizatat ndërkombëtare. Personeli i NJIF-K ka marrë pjesë në gjithsejt 23 trajnime dhe seminare vendore dhe ndërkombëtare, nga të cilat 18 ishin të ndërlidhura me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit ose veprave tjera të ngjashme.

Trajnimet vendore në të cilat stafi i NJIF-K ka marrë pjesë, kryesisht përmbanin temat si në vijim:

- Teknikat e Hetimeve Financiare,
- Kodi Penal, Kodi i procedurës Penale, Parandalimi i SHP/FT, Konfiskimi i aseteve, Financimi i terrorizmit
- Takim i Grupi punues për standardizimin e formave të kallezimeve penale dhe të statistikave
- Kursi ndërkombëtar për zbulimin dhe kthimin e aseteve
- Seminar "Luftimi i Ekstremizmit dhe Radikalizmit të dhunshëm"
- Teknikat e Avancuara të hetimeve financiare
- Mbikqyrja e Pajtushmërisë në PPP/PFT
- Përcjellja e parasë
- Procesi i Punës i bazuar në goAML

Stafi profesional i NJIF-K, gjithashtu ka marrë pjesë në trajnimet dhe aktivitetet tjera ndërkombëtare, të organizuara në nivel rajonal dhe ndërkombëtar:

- Konferenca Rajonale në "Adaptimin e prioriteteve strategjike në bashkëpunimin kundër krimeve kibernetike", e mbajtur në Dubrovnik të Kroacisë;
- Punëtorja dhe kursi i PPP/PFT, Metodologjia e Standardeve të reja të FATF, organizuar nga FMN dhe JVI Vienna dhe mbajtur në Vienë, Austri;
- Procesi i Marrëveshjes së Stabilizimit Asociimit (MSA), Kapitulli 23. Gjyqësori dhe të Drejtat Fundamentale; Kapitulli 24, Drejtësia, Liria dhe Siguria, mbajtur në Durrës, Shqipëri;
- Kursi akademik i Drejtësisë Penale, Forumi i Krimit të organizuar shumëkombësh, financuar dhe organizuar nga Departamenti i Shtetit dhe ILEA Roswell, New Mexico, SHBA ;
- Qasja Europiane si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar në luftë kundër krimeve financiare, mbajtur në Dubrovnik, Kroaci








ILEA Roswell: *Kursi akademik i Drejtësisë Penale, Forumi i Krimin të organizuar shumëkombësh*

#### 4.8.4. Bashkëpunimi me partnerët kombëtar

NJIF-K së bashku me institucionet dhe organet tjera në Kosovë obligohen të bashkëpunojnë në mënyrë reciproke, të ndihmojnë njëra tjetrën gjatë kryerjes së detyrave të tyre si dhe t'i koordinojnë aktivitetet në kuadër të kompetencave të tyre në pajtueshmëri me ligjet e aplikueshme në luftën për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave dhe financimin e terrorizmit, dhe kjo e ka shtyrë edhe më tepër NJIF-K për të vazhduar edhe më tepër bashkëpunimin intenziv me institucionet tjera të zbatimit të ligjit duke pas rritje të shkëmbimit të informatave dhe përvojave në mes institucionve të drejtuara në mënyrën e të kuptuarit të verpës penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe veprave tjera të ndërlidhura me qëllim të rritjes së efikasitetit për mbledhjen indirekte të provave përmes metodave dhe praktikave ndërkombtarisht të përdorura për luftimin e atyre dukurive negative.

Një fokus i veçantë i punës me sektorin publik i është kushtuar edhe vazhdimi i mbajtjes së trajnimeve dhe prezantimeve nga stafi i njësisë, ku në bashkëpunim me Institutin kundër Krimeve Ekonomike dhe Institutin Gjyqësor të Kosovës dhe mbështetur nga Projekti i BE B&S, gjatë kësaj periudhe raportuese janë mbajtur 10 trajnime në të cilat janë trajnuar mbi 300 zyrtar të institucioneve të zbatimit të ligjit në lidhje me Teknikat e Hetimeve Finaciare, Kodin Penal dhe Kodin e procedurës penale, Parandalimi i PP/FT, financimi i terrorizmit, konfiskimi i asetëve, luftimi i korrupsionit, Percjell Paratë, Ndjekja e Pasurive dhe Konfiskimi etj.



#### 4.8.4.1. *Grupet Punuese dhe Planet e Veprimit të Strategjive Nacionale*

Njëherit NJIF ka dhënë kontribut në sekretariatit dhe grupin teknik ndërinstitucional për draftimin e Strategjia Kombëtare të Republikës së Koso

vës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimin e Parave, Financimin e Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Poashtu, NJIF ka qenë pjesëmarrëse aktive dhe ka kontribuar në vazhdimësi në implementimin dhe rishikimin e tri strategjive kombëtare: Strategjinë Kombëtare kundër krimit të organizuar, Strategjinë Kombëtare kundër Terrorizmit dhe Strategjinë kombëtare për parandalimin e krimit.

#### 4.8.4.2. *Memorandumet e Mirëkuptimit*

Njësia për Inteligjencë Financiare me datë 19/02/2013 ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi mbi Shkëmbimin e Informatave me Policinë e Kosovës. Qëllimi i nënshkrimit të memorandumit ka qenë që të shtohet bashkëpunimi dhe koordinimi mbi shkëmbimin e informatave në mes të palëve, në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, parandalimin e financimit të terrorizmit dhe veprave tjera penale që ndërlidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.

NJIF-K dhe PK janë zotuar që, kur është e mundur, e përshtatshme dhe kërkohet nga pala tjetër, të shkëmbejnë informata në mënyrë elektronike dhe të kenë një zyrtarë ndërlidhës nga PK i cili do të jetë pikë e përbashkët e kontakti për komunikim në mes të dy institucioneve.

Më pas me qëllim të implementimit të memorandumit të lartcekur dhe shkëmbimit të informatave në mënyrë elektronike, NJIF-K dhe PK me datë 07/10/2013 kanë nënshkruar një aneks Memorandum.



### ***Memorandumi i Bashkëpunimit NJIF-K dhe BQK***

Sa i përket bashkëpunimit me Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, NJIF-K dhe BQK me qëllim të implementimit të nenit 36 A (Inspektimi i Pajtushmërisë nga BQK) të Ligjit Nr. 03/L -196 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-178, me datë 11/06/2013 ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informatave.

Qëllimi i Memorandumit ka qenë ngritja e nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimi si dhe ngritja e nivelit të sigurisë së shkëmbimit të informatave, dhe përsheptimi i procesit të shkëmbimit të informatave në mes të Palëve, në lidhje me parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit.

Memorandumi ka pasur për qëllim edhe delegimin e autorizimit tek BQK sipas nenit 36A të ligjit të plotësuar dhe ndryshuar për të bërë inspektime të pajtushmërisë me NJIF-K në harmoni me dispozitat e ligjeve Nr. 03L-196 dhe Nr. 04/L-178 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Parandalimit të Financimit e Terrorizmit. BQK si autoritet licencues, mbikëqyrës dhe rregullues i sektorit financiar i është dhënë përgjegjësi për inspektime të pajtushmërisë së sektorit financiar në kontekst të parandalimit të pastrimit të parave dhe parandalimit të financimit të terrorizmit duke u bazuar në kornizën ligjore për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit dhe akteve nënligjore të lëshuara nga NJIF-K.

*Nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit në mes të NJIF-K dhe BQK*



#### 4.8.4.3. ILECUs

Përfaqësuesi i NJIF-K si anëtar i grupit punues dhe person kontaktues me zyrën ILECUs që si synim ka krijimin e njësave koordinuese Kombëtare që ndikon në formën e bashkëpunimit institucional në luftën kundër krimit të organizuar, ka qenë vazdimisht në mbështetje të projektit për themelimin dhe fuqizimin e kësaj njësie të bashkëpunimit ndërinstytucional.

#### 4.8.5. Bashkëpunimi me homologët e huaj dhe Grupin Egmont

##### 4.8.5.1. *Shkëmbimi ndërkombëtar i informacioneve*


Fenomeni i pastrimit të parave karakterizohet nga fakti se, në shumicën e rasteve, pastrimi i parave gjithnjë e më tepër është duke i prekur shumicën e vendeve të botës dhe njëherit duke i kaluar në shumicën e rasteve kufijt nacional dhe ata tej oqeanik. Për këtë arsye, shkëmbimi ndërkombëtar i informacionit në mënyrë intensive dhe efikase do të ketë impakt pozitiv në luftën kundër këtyre fenomeneve negative.

Ligji PPP/ PFT i jep mandat NJIF-K që spontanisht ose me anë të kërkesës, të ndajë informacionet me çdo agjenci homologe të huaj që kryen funksione dhe i nënshtrohen obligimeve të ngjashme për ruajtjen e konfidencialitetit, pavarësisht nga natyra e agjencisë e cila i nënshtrohet reciprocitetit. Informacioni i ofruar përdoret vetëm me miratimin e agjencisë dhe vetëm për qëllime të luftimit të shpërlarjes së parave, të veprave të ndërlidhura penale dhe të financimit të terrorizmit.

NJIF-ja është në gjendje për të shkëmbyer ndërkombëtarisht të gjitha informatat që mund të jenë të arritshme apo të mundura direkt ose indirekt nga NjIF.

Bashkëpunimi ndërkombëtar	2011	2012	2013
<b>KËRKESAT E PRANUARA</b>			
Kërkesat e huaja të pranura nga NjIF	10	10	7
Kërkesat e huaja të ekzekutuara nga NjIF	11	13	6
Kërkesat e huaja të refuzuara nga NjIF	0	0	0
Ndarja spontane e informacioneve të pranura nga NjIF	0	0	2
Numri mesatar i ditëve për t'iu përgjigjur kërkesave nga NjIF-ët e huaj	49	33	26
Aplikimi i bazave të refuzimit	0	0	0

Tabela nr.12



#### 4.8.5.2. Bashkëpunimi regjional

Në Tetor 2013 në Durrës të Shqipërisë është mbajtur konferenca rajonale e Drejtorëve të Njësive të Inteligjencës Financiare të Europës Juglindore. I ftuar në këtë konferencë ishte edhe Drejtori i NJIF-K, duke dhënë shenja të zgjerimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit të vendeve të rajonit.

Ky forum përbëhet nga përfaqësues të NJIF të Shqipërisë, Bosnje e Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Mali i Zi, Serbisë dhe Sllovenisë. Bashkëpunimi me anëtarët e Grupit Punues Regjional të NJIF duket të jetë shumë i rëndësishëm për NJIF-K. Shumica e kërkesave apo shkëmbimit për informata ndërkombëtare në nivelin operacional ka të bëjë me shtetet fqinje. Objektiva e NJIF-K është të bëhet anëtare e Grupit Punues Regjional të Njësive të Inteligjencës Financiare të Ballkanit.

#### 4.8.5.3. Memorandumet e Mirëkuptimit

NJIF-K mund të nënshkruajë një kontratë ose marrëveshje me një agjenci homologe të huaj e cila kryen funksione të ngjashme dhe i nënshtrohet obligimeve të ngjashme për ruajtjen e fshehtësisë.

Në Dhjetor 2013, NJIF Kosovë ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me NJIF e Finalndës e cila njëherit e ka mbështetur NJIF-K në procesin e anëtarësimit në Egmont Grup. Ky bashkëpunim rezultojë gjithashtu me nënshkrimin e kësaj MeM mes këtyre dy agjencive.

Që nga viti 2009, Njësia e Inteligjencës Financiare e Kosovës ka nënshkruar MeM me gjithsej nëntë (9) shtete, duke përfshirë këtu vende nga rajoni i Ballkanit Perëndimorë, vende të Bashkimit Europian si dhe me FIU nga Turqia dhe San Marino.

Memorandumet e Mirëkuptimit me FIU ndërkombëtare	Viti
Shqipëri	2009
Maqedoni	2009
Mali i Zi	2009
San Marino	2009
Sllovenia	2009
Kroaci	2010
Turqia	2012
Republika Çeke	2012
Finlanda	2013

Tabela nr.13



#### 4.8.5.4. *Procesi i Anëtarësimit në Grupin Egmont*

NJIF-K me mbështetje të projektit të financuar nga BE ka kontaktuar Sekretariatit e Grupit Egmont me 12.8.2013. Objektiva ishte të qartësohet gjendja sa i përket aplikimit për anëtarësim në përgjithësi dhe veçanërisht sa i përket agjencisë.

Shprehja e interesit apo aplikimi zyrtar i NJIF-K sa i përket anëtarësimit në Grupin Egmont është dorëzuar tek Sekretari Ekzekutiv i Sekretariatit të Grupit Egmont më 29.08.2013. Procesi është iniciuar me mbështetjen e FIU Finlandë, FIU Senegal dhe FIU Slloveni të cilat aprovuan sponsorizimin bazuar në kërkesën e NJIF-K.

Procesi i anëtarësimit të NJIF-K në Egmont Grup u ndalua në Dhjetor të vitit 2013 në bazë të kundërshtimeve të katër FIU anëtare të Egmontit. Grupi Punues i Arritshmërisë ka vendosur që Sponsorat e NJIF nuk mund ta kryejnë vizitën e planifikuar në Kosovë në Janar 2014.

Procedura e aplikimit për anëtarësimin e NJIF-K ishte përfshirë në agjendën e mbledhjes së Këshillit të Egmontit e cila do të mbahej në Budapest në Shkurt të 2014. Është vendosur që procesi duhet të vazhdohet dhe Sponsorat e NJIF duhet t'u lejohet të mbajnë vizitën në terren.

FIU e Finlandës, Senegalit dhe Sllovenisë pritet të mbajnë vizitën në terren në vitin 2014. Shtetet sponsore të NJIF do të përgadisin një raport. Përfundimi i raportit të sponsorëve nga NJIF Finlandë, NJIF Senegal dhe NJIF Slloveni do të konkludoj nëse NJIF-K i plotëson kërkesat për anëtarësim dhe pastaj do të miratohet ose jo anëtarësimi i NJIF-K si anëtar i Grupit Egmont gjatë Seancës Plenare. NJIF-K pritet të ftohet për herë të parë në takimin Vjetore Plenare të Egmont Grupit i cili do të mbahet në Lima të Perus në Qershor 2014.



## 5. MENAXHIMI I RREZIKUT NË PASTRIM TË PARAVE DHE FINANCIM TË TERRORIZMIT

### 5.1. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut 2013

Me 19.08.2013 është kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës që NJIF-K të hartoj dhe kryej Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë 2013. Njësia ka iniciuar punën duke themeluar Grupin Punues të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të përbërë nga përfaqësues të institucioneve relevante të sektorit publik, privat dhe të tretë dhe së bashku me Ministrin e Financave kanë hartuar një Udhëzim Administrativ për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit<sup>2</sup> që definojnë në detaje procesin e vlerësimit të rrezikut të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ky instrument ligjor është në pajtim me Rekomandimin e parë (1) të FATF<sup>3</sup>. Procesi i definuar në udhëzime është baza për menaxhimin e rrezikut të nivelit kombëtar dhe planifikimin strategjik sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Udhëzimi Administrativ për Vlerësimin e Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit ishte aprovuar nga Ministri i Financave më datë 06.09.2013.

NJIF-K me mbështetjen e Grupit Punues të Vlerësimit të Rrezikut ka definuar kriteret për përdorim për të vlerësuar rëndësinë e rreziqeve duke përcjellë Standardet ISO 31000.<sup>4</sup> Është vendosur që kriteret e rrezikut duhet të reflektojnë vlerat dhe objektivat e legjislacionit relevant Kombëtar dhe shoqërisë në përgjithësi. Kështu, kriteret bazohen në Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit<sup>5</sup> dhe Programit Qeveritar të Republikës së Kosovës 2011-2014<sup>6</sup> për të siguruar identifikim të kërcënimeve dhe dobësive që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet ekonomike financiare dhe ekonominë joformale.

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2013, ishte bazuar në komunikimin dhe konsultimin e zgjeruar me akterët relevant kombëtar. Kriteret e definuara të rrezikut në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut 2013 ishin siç vijon:

1. Parandalim dhe zbulim efikas i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
2. Zhvillim i qëndrueshëm ekonomik;
3. Qeverisje e mirë dhe fuqizim i Sundimit të Ligjit;
4. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
5. Mirëqenie Sociale.


<sup>2</sup>Udhëzimi Administrativ Mf - Nr. 04/ 2013 në Vlerësimin e Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, Ministria e Financave, 2013.

<sup>3</sup>Standardet Ndërkombëtare për Luftimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit & Shtojca (Rekomandimet FATF), FATF 2012.

<sup>4</sup>Menaxhimi i Rrezikut - Parimet dhe udhëzimet, Standardet Ndërkombëtar ISO31000, 2009.

<sup>5</sup>Ligji Nr. 03/L-196 dhe Ligji Nr. 04/L-178 në Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit, 2010 dhe 2013.

<sup>6</sup>Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.



NJIF-K dhe Grupi Punues i Vlerësimit të Rrezikut Kombëtar vendosën të rekomandojnë tek Qeveria e Republikës së Kosovës që rezultatet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013 duhet të përdoren gjithashtu për parandalim të ekonomisë joformale dhe krime financiare e ekonomike. Kjo u bë për shkak të faktit se gjatë procesit të vlerësimit të rrezikut këto fenomene të dëmshme u konsideruan të lidhura me njëra tjetrën.

Vlerësimi i Rrezikut Kombëtar të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2013, ka gjeneruar një listë të cilave i është dhënë prioritet i veçantë që përmbajn gjithsej 35 rreziqe të identifikuar që janë klasifikuar në kërcënime dhe dobësi që kanë të bëjnë me ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare.

Ky Vlerësim i Rrezikut është aprovua nga Qeveria e Republikës së Kosovës me 18.12.2013. Vlerësimi i rrezikut Kombëtar të PP/FT ishte aprovuar bashkë me dokumentat e mëposhtme:

- Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut i Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit Kosovë 2013;
- Matrica e Analizës dhe Vlerësimit për Rreziqet Individuale;
- Plani i Veprimit për Masat e Trajtimit për rreziqet e identifikuar.

## **5.2. Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018**

NJIF-K ishte anëtare e grupit punues të nivelit kombëtar që hartoi Strategjinë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Qëllimet, objektivat dhe veprimet e këtij dokumenti janë bazuar në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut për Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013.

Qëllimet e Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 janë:

- Mbështetja në arritjen e objektivave të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014;
- Përpjekje për reduktimin e shkallës së ekonomisë joformale për 5% mes 2014 dhe 2018. Rrjedhimisht, vlera e ekonomisë formale si subjekt i taksave dhe procedurave doganore do të rritej për të paktën 52,000,000 EUR<sup>7</sup> deri më 31.12.2018. Kjo duhet të rris volumin vjetor të të hyrave të mbledhura;
- Duhet bërë përpjekje për rritjen e vlerës totale të konfiskimeve të të ardhurave të krimit. Për vitin 2014 vlera e konfiskuar e të ardhurave të krimit inkurajohet të rritet në 500,000 EUR. Gjatë 2015-2018 vlera e konfiskuar e të ardhurave të krimit parashihet të jetë 1,000,000 EUR në baza vjetore.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018

<sup>7</sup> Vlera është bazuar në BPV të Kosovës nga 2012.





përfshinë objektivat e mëposhtme strategjike që janë përgjigje në rreziqet e identifikuar të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare:

1. Ngritja e vetëdijes në ndikimin dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare;
2. Fuqizimi i parandalimit dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke rritur transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mirë dhe partneritetin shoqëror;
3. Promovimi i procedurave të inteligjencës , hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
4. Fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve relevante;
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive në bashkëpunimin ndërkombëtar në parandalim të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve tjera financiare;
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar për t'u përafuar me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i implementimit të tij efikas.

Plani i Veprimit 2014-2018 i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalim dhe Luftim e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 përmban gjithsej 51 aktivitete individuale që duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike.

Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018 përfshin gjithashtu Instrumentin e Monitorimit dhe Rishikimit. Është mjet që është planifikuar për vlerësimin e procesit të implementimit dhe për identifikimin e rishikimit dhe nevojat e amendamentimit sa i përket strategjisë kombëtare.

### **5.3. Mekanizmi kombëtar i menaxhimit të rrezikut për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit**


NJIF-K ka mbështetur Qeverinë e Republikës së Kosovës në themelimin e mekanizmit kombëtar të menaxhimit të rrezikut në ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare. Ky mekanizëm është bazuar në standardet ndërkombëtare<sup>8,9,10</sup> dhe përmban dokumentet si në vijim:

- Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit Kosovë 2013;
- Matrica e Analizimit dhe Vlerësimit për Rreziqet Individuale të Identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut 2013;
- Plani i Veprimit për Masat e trajtimit të rreziqeve të identifikuara në Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit, Kosovë 2013;
- Vlerësimit e Rrezikut sektorial në ekonominë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet financiare në Kosovë;

<sup>8</sup>Menaxhimi i rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

<sup>9</sup>Menaxhimi i rrezikut –Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.

<sup>10</sup>FATF Udhëzimet e Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit, 2013.



- Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018;
- Plan i Veprimit i Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018;
- Planet e Buxhetit dhe Performancës së institucioneve relevante publike 2014-2018;
- Platforma që siguron partneritetin mes institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë sa i përket hartimit, rishikimit, adoptimit, implementimit dhe monitorimit të instrumenteve të menaxhimit të rrezikut;
- Raporti i Situatës që hartohet çdo tre (3) muaj dhe që përmban informata për statusin dhe rezultatet e procesit të implementimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018 dhe informata bazuar në situatën aktuale dhe zhvillimet sa i përket performancës operative dhe rezultateve në parandalimin e ekonomisë joformale dhe pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimet tjera financiare.

Procedura e menaxhimit të rrezikut në Kosovë është në pajtueshmëri me Udhëzimet e FATF të Vlerësimit Kombëtar të Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit<sup>11</sup> dhe standarde ISO 31000<sup>12</sup> dhe 31010<sup>13</sup>. Ajo bazohet në konsultimet dhe komunikimet e zgjeruara më partnerët përfshirë institucionet më relevante të sektorit publik dhe privat. Rritja e partneritetit mes këtyre akterëve është shumë e rëndësishme dhe kjo veq është arritur.

Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit në Kosovë 2013 është bazë për hartimin e objektivave dhe veprimeve të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Kjo do të siguroj një menaxhim të vazhdueshëm të rreziqeve.

NJIF-K është përgjegjëse për implementimin e vlerësimeve të rrezikut sektorial duke u fokusuar në sektorët dhe degët më të cenuara ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit që kërkohen në aktivitetin 2.2.11 të Planit të Veprimit 2014-2018 të Strategjisë Kombëtare së Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Pajtueshmëria e këtyre sektorëve dhe degëve duhet të jetë e vlerësuar dhe siguruar me Ligjin për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Rezultatet e vlerësimit të rrezikut sektorial duhet inkorporohen gjatë rishikimit dhe amendamentimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018.

<sup>11</sup>Ibid.

<sup>12</sup>Menaxhimi i Rrezikut – Parimet dhe udhëzimet, Standardet Ndërkombëtare ISO 31000, 2009.

<sup>13</sup>Menaxhimi i Rrezikut – Teknikat e vlerësimit të rrezikut, Standardet Ndërkombëtare ISO 31010, 2009.



## 6. MBËSHTETJA NDËRKOMBËTARE

### 6.1. *Bashkëpunimi me EULEX-in*

Bashkëpunimi i frytshëm mes dy institucioneve ka vazhduar edhe gjatë vitit 2013. Duhet theksuar se edhe pas përfundimit të tranzicionit dhe bartjes së kompetencave, në Njësinë për Inteligjencë Financiare ka vazhduar prezenca e stafit të misionit të EULEX-it. Katër punonjës të misionit të EULEX-it, ne mesin e tyre një këshilltar i Drejtorit të NJIF-K, dy analistë të Inteligjencës dhe një zyrtarë mbështetës vazhdojnë të japin kontributin e tyre duke ndihmuar institucionin në zbatimin e mandatit ligjor dhe ngritjen e bashkëpunimit dhe kapaciteteve në fushën e parandalimit dhe luftimit të shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit.

### 6.2. *Projektet e financuar nga BE-ja*


NJIF Kosova është përfituesi primar i projektit “Mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimën kundër krimeve financiare dhe ekonomike” qëllimi i të cilit është të fuqizoj Njësinë e Inteligjencës Financiare, Ministrinë e Financave, agjencitë e zbatimit të ligjit, autoritete gjyqësore dhe autoritetet tjera relevante në zbatimin efikas të harmonizimit dhe gjithë përfshirjes së kornizës ligjore dhe rregullative për luftimin e krimeve financiare. Projekti është financuar nga Komisioni i BE-së, menaxhuar nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe implementuar nga kompania B&S Europe. Ekipi i Projektit ka filluar punën në vendin tonë që nga Qershori i vitit 2013.

Projekti përmban në vete gjithsej shtatë (7) Komponente. Ato janë të ndara në gjithsej 35 aktivitete që përmbajnë dizajnimin e kornizës ligjore dhe kornizës rregullative, ngritjes së kapaciteteve të NJIF dhe institucioneve tjera relevante, ndërgjegjësimi dhe zbatimi i strategjisë, vlerësimi i ekonomisë joformale, çertifikimi i Ekspertëve Financiare, çertifikimi i Ekspertëve Kompjuterik dhe rishikimi i Ligjit të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.

Sa i përket dizajnimin të kornizës rregullative, Ekipi i Projektit ka mbështetur NJIF dhe përfituesit tjerë në hartimin e gjithsej katërmëdhjetë (14) akteve nënligjore. Qëllimi i kësaj ka qenë rritja e implementimit të Ligjit për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Ekspertët e Projektit së bashku me NJIF dhe akterët tjerë kanë hartuar gjithashtu dhjetë (10) Procedura Standarde të Veprimit për të zhvilluar proceset e tyre të brendshme dhe bashkëpunimin. Përveç tjerash, këto dokumente definojnë zgjidhjet ligjore dhe teknike të TI që janë krijuar për të siguruar shkëmbimin automatik dhe të intensifikuar të informatave dhe avancimin e bashkëpunimit operacional mes NJIF dhe Policisë së Kosovës dhe Administratës Tatimore të Kosovës.

Ekipi i Projektit ka mbështetur gjithashtu NJIF-K në procesin e aplikimit për anëtarësim në Egmont Grup. Faza fillestare veç ka përfunduar. Përveç rezistencës politike të disa vendeve anëtare, pritet që NJIF-K do të bëhet anëtare e Grupit Egmont në Qershor 2015.

Projekti i BE-së ka prodhuar gjithashtu raport të gjera analitike të quajtura “Rishikimi Organizativ dhe Vlerësimi i Bashkëpunimit Strategjik dhe Operacional në Parandalimin e Krimeve



Financiare dhe Ekonomike” dhe “Vlerësimi i Kornizës Ligjore të PPP/PFT në Kosovë”. Ato janë përdorur si bazë për implementimin e projektit, por rekomandimet e këtyre raporteve analitike janë përfshirë gjithashtu edhe në veprimet e “Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit të Republikës së Kosovës për Parandalimin dhe Luftimin Kundër Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018” (Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit 2014-2018).

Sa i përket ngritjes së kapaciteteve, Ekipi i Projektit dhe NJIF kanë themeluar Grupet Punues të Koordinatorëve të Trajnimeve për sektorët publik, privat dhe të tretë. Ky proces është përfshirë në raportin “Analizimi i Nevojave të Trajnimit, Programi i Trajnimit dhe Strategjia e Trajnimit për Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës dhe institucionet tjera të përfshira në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare”. Ai përmban gjithsej 22 module të ndara të trajnimit. Programi i Trajnimit është përfshirë në Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit 2014-2018 dhe në kurrikulën e trajnimeve të instituteve lokale. Ekipi i Projektit ka filluar të mbështes NJIF dhe institucionet tjera relevante në implementimin e moduleve të identifikuar të trajnimit që rrisin kapacitetin e sektorëve publik, privat dhe të tretë.

Ekipi i Projektit të BE-së po ashtu ka mbështetur NJIF-in dhe institucionet tjera të sektorit publik, privat dhe të tretë në krijimin e mekanizmit të menaxhimit të rrezikut në ekonomin joformale, pastrim të parave, financim të terrorizmit dhe krime financiare. Ai përmban Vlerësimin Kombëtar të Rrezikut në Pastrim të Parave dhe Financim të Terrorizmit 2013 që është hartuar nga grupi punues i udhëhequr nga NJIF dhe është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës më 18.12.2013. Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut ishte baza për procesin që rezultojë në hartimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit 2014-2018. Ky dokument përfshin masat e trajtimit për rreziqet e nivelit kombëtar dhe përmban udhërrëfyesin për autoritetet lokale sa i përket parandalimit të ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare. Ekipi i Projektit ka ndihmuar gjithashtu NJIF dhe përfituesit tjerë në implementimin e strategjisë së monitorimit dhe matjen e efikasitetit operativ të institucioneve lokale duke mbështetur Qeverinë në themelimin e Raportit të Situatës në baza kuartale. Ky instrument ofron informata për ambientin operativ dhe matë efikasitetin strategjik dhe operacional të institucioneve të sektorit publik, privat dhe të tretë. Ekipi i Projektit dhe NJIF kanë themeluar gjithashtu, me mbështetjen e institucioneve relevante, vlerësimin e pare të rrezikut të sektorit specifik në pastrimin të parave dhe financim të terrorizmit në sektorin e ndërtimit.

### **6.3. Projekti i BE&KE “kundër Krimin Ekonomik në Kosovë PECK”**

Njësia për Inteligjencë Financiare ishte pjesë e Projektit Kundër Krimin Ekonomik (PECK). Ky projekt financohet dhe implementohet nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli i Evropës. NJIF-K në kuadër të këtij projekti është institucion bartës dhe koordinues i komponentës kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit. Vlerësimi i sistemit të Kosovës në luftimin e pastrimit të parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit është bazuar në Rekomandimet e FATF-së të vitit 2003 dhe në Rekomandimet e veçanta mbi Financimin e Terrorizmit të vitit 2001 të Task Forcës së Veprimit dhe është përgatitur duke përdorur metodologjinë e vlerësimit LPP/LFT 2004. Pyetësor të ndarë, po ashtu të bazuar në Metodologjinë e FATF, janë përgatitur për dy



ciklet e vlerësimit dhe kanë paraqitur bazën për dy vizitat në terren. Ky është vlerësimi i parë i kompletuar i përputhshmërisë së Kosovës me standarde ndërkombëtare të LPP/LFT.

Për më tepër, në atë raport vlerësimi mbulohen gjithashtu një mori çështjesh të përzgjedhura në lidhje me Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të Evropës, për parandalimin e shfrytëzimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (“Direktiva e tretë e BE-së”) dhe Direktiva 2006/70/EC e Komisionit Evropian mbi vendosjen e masave implementuese për Direktivën 2005/60/EC të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian në lidhje me definicionin e “personave të ekspozuar politikisht” dhe kriterëve teknike për procedura të thjeshtësuara të kujdesit të duhur të klientit dhe për përjashtimin mbi bazat e aktivitetit financiar të kryer në baza të rëndomta dhe shumë të kufizuara ( “Direktiva e zbatimit”), si dhe një mori elementesh të Konventës së Këshillit të Evropës për Pastrimin, Kërkimin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi dhe për Financimin e Terrorizmit (STKE 198).

Të dy ciklet e vlerësimit janë bazuar në ligje, rregullore dhe materiale të tjera të siguruara nga autoritetet e Kosovës, si dhe në informatat e siguruara nga ekipi i vlerësimit gjatë vizitës në terren. Vlerësimi është kryer nga një ekip vlerësimi i Projektit të Përbashkët të BE/KE kundër Krimit Ekonomik në Kosovë (PECK), i cili përbëhej nga ekspert të MONEYVAL dhe GRECO. Njëherit ky vlerësim përshkruan dhe analizon masat e LPP/LFT, si dhe ofrohen rekomandime se si disa aspekte të sistemit të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në Kosovë do të mund të fuqizoheshin.

Ekspertët bënë shqyrtimin e kornizës institucionale, të ligjeve, rregulloreve, udhëzuesve dhe të kërkesave të tjera të LPP/LFT-së, si dhe të rregullatorëve dhe sistemeve të tjera të krijuara për pengimin e Pastrimit të Parave (PP) dhe Financimit të Terrorizmit (FT) përmes institucioneve financiare, dhe Biznese dhe Profesioneve të Caktuara Jo Financiare (BPCJF-të) si dhe bënë ekzaminimin e kapacitetit, zbatimit dhe efikasitetit të të gjitha këtyre sistemeve. Struktura e këtij Raporti përgjithësisht është bazuar në strukturën e Raporteve të vlerësimeve të MONEYVAL dhe FATF.

#### **6.4. Mbështetja nga Thesari i Shteteve të Bashkuara**

Zyra për Asistencë Teknike e departamentit të Thesarit Amerikan në Kosovë, ka dhënë dhe vazhdon të japë kontribut të çmuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe operacionale duke ofruar ligjërime dhe asistencë subjekteve raportuese dhe institucioneve të zbatimit të ligjit, në lidhje me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit, mandatin ligjor dhe operacional të NJIF-it dhe rëndësinë e mbështetjes nga NJIF për institucionet tjera të zbatimit të ligjit. Përveç mbështetjes që ka dhënë NJIF-K në themelimin dhe fuqizimin e Institutit kundër Krimeve Ekonomike, roli i njësisë dhe Thesarit Amerikan ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm edhe në themelimin e zyrës së Kordinatorit Nacional. Si rezultat i këtij bashkëpunimi disa vjeçar në mes këtyre dy institucioneve, NJIF-K dhe Zyres për Asistencë Teknike, kjo e fundit mundësoj që Njësia për Inteligjencë Financiare të përfaqësohet për herë të parë në ILEA, Roswell në Akademinë dhe Kursin një mujor për drejtësin penale dhe krminin e organizuar transnacional.

## 7. PLANI I PERFORMANCËS DHE RESURSEVE TË NJIF KOSOVË 2014-2016

NJIF-K ka themeluar Planin e Performancës dhe Resurseve 2014-2016. Ky plan strategjik përcakton se si njësia do të ndërtoj asetet e saj dhe arrijtjet e larta për të kaluar sfidat që do ballafaqohet në tri vitet e ardhshme, dhe se si agjencia do të siguroj pozitën e saj si një nga njësitë udhëheqëse të inteligjencës në Kosovë dhe në regjion. Përshkruhet gjithashtu se si NJIF-K do të mat suksesin e saj dhe kontrolloj proceset e saj të brendshme. Plani i Performancës dhe Resurseve 2014-2016 përfshin kapitujt e mëposhtëm:

1. Prezantim i denfinimeve të detyrave, misionit, vizionit, qëllimeve dhe organizimit të njësisë;
2. Ambienti Operacional dhe Vlerësimi i Rrezikut i NJIF-K;
3. Objektivat, Zyrtarët Përgjegjës, Planet e Veprimit dhe Indikatorët e Performancës të NJFI-K;
4. Burimet Financiare, Njerëzore dhe të Teknologjisë Informative dhe Plani i objektit dhe zyreve për NJIF-K.

Plani i Performancës dhe Resurseve 2014-2016 definojnë objektivat strategjike të NJIF-K. Ai gjithashtu përmban planet për t'i arritur ato dhe indikatorët kyç të performancës për të matur efikasitetin e agjencisë. Objektivat strategjike të NJIF-K për 2014-2016 janë siç vijon:

1. Ngritja e Vetëdijes dhe Komunikimit në luftën kundër Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit;
2. Promovimi i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe intensifikimi i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë;
3. Zhvillimi, standardizimi dhe intensifikimi i raportimit, inteligjencës dhe proceseve të analizës dhe promovimi i bashkëpunimit me shumë-agjenci sa i përket zbulimit dhe hetimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe konfiskimi i të ardhurave të krimit;
4. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar KPP/LFT dhe standardeve të brendshme të NJIF-K dhe sigurimi i implementimit efikas të tyre;
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes proaktive për bashkëpunimin ndërkombëtarë në parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
6. Ngritja e kapaciteteve të NJIF-K.

Plani i Performancës dhe Resurseve 2014-2016 përmban gjithashtu planin për alokimin e burimeve dhe kontroleve të brendshme.





Rr. Eduard Lir Nr.1 – Arbëri – Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 247 105 – Fax: +381 38 247 103

[www.fic-ks.org](http://www.fic-ks.org)

[fic@fic-ks.org](mailto:fic@fic-ks.org)

